

VENDIM
Nr. 20, datë 12.4.2017

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA I PËR
VITIN 2017, TË GRANTIT “REHABILITIM MJEDISOR, GJELBËRIM DHE
PYLLËZIM”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE, SHTYLLA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr.130 datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I për vitin 2017, për grantin “Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, me burim financimi buxhetin e projekteve të reja për vitin 2017, nga programi buxhetor “Administrimi i pyjeve” pranë Ministrisë së Mjedisit, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për financim sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në “Fletoren Zyrtare”, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik, pranë Ministrisë së Mjedisit, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të projektit, si dhe të përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e projektit, përpara fundit të tremujorit të dytë, të vitit 2017. Për fondet e projekteve të paprokuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t’i rishpërndajë ato për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Mjedisit, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Financave dhe Ministri i Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1 Lista e projekteve të reja, thirrja I për vitin 2017, për grantin “Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, me cikël zbatimi 2017-2018

Nr	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
QARKU ELBASAN				
1	Bashkia Prrenjas	Gjelbërimi nëpërmjet pyllëzimeve i kurorës së qytetit Prrenjas.	12,000,000	12,000,000
QARKU SHKODËR				
2	Bashkia Vau i Dejës	Gjelbërimi i mjedisve publike të Bashkisë ‘Vau i Dejës’	87,000,000	87,000,000
TOTALI			99,000,000	99,000,000

Shënim: 1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e financimit për projektin, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. “Vlera e financimit për vitin 2017” është financimi që jepet për vitin 2017, me burim fondin për projekte të reja, të programit buxhetor “Administrimi i pyjeve” të Ministrisë së Mjedisit, për vitin 2017.